



01/Nr. 1201/2024
Data : 09.02.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.01.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsime Kulturë, Rini dhe Sport), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim)

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2023.
3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024.
4. Plani i punës së Këshillave të Fshatrave për vitin 2024.
5. Kërkesë për shfuqizimin e Planit të Integritetit me numër protokoli 01/6387/2022.
6. Kodit i Etikës dhe Mirësjelljes – Komuna Hani i Elezit.
7. Diskutim rreth raportit të auditorit social.
8. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 4 për , 1 abstenim.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- për këtë pikë të rendit të punës materiali na është dërguar me vonesë . për pikat e rendit të ditës është mirë me na u dërguar komplet materiali mos me pasur vonesa.

Kryesuesi thekson:- materialin për këtë pikë të rendit të ditës e kam diskutuar me drejtoreshën dhe arsyetimi i saj ishte se për shkak qasjen në sistem që nuk ka pasur dhe mendoj që është e arsyeshme.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni pranuar me vonesë për shkak se nuk kemi pasur qasje në sistem, kështu që raporti është përcjell gjashtë ditë para mbajtjes së mbledhjes. Materiali nuk është i kompletuar njëqind për qind pasi që nuk jemi të barazuar as me thesar dhe nuk i kemi pranuar të hyrat indirekte të cilat na i përcjellë divizioni i të hyrave përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Për mbledhje të Kuvendit na dërgohet raporti i TM4 nga të hyrat indirekte dhe atëherë raporti financiarë do të jetë i kompletuar. Realizimi i të hyrave direkte për vitin 2023 është në shumë prej 358,141.65 € dhe nëse krahasohet me vitin 2022 kemi një ngritje prej 24,139.98 € që do të thotë se të hyrat direkte dhe indirekte për vitin 2023 janë në shumë prej 404,227.82 € dhe në raport e kam potencuar se nuk janë përfundimtare për shkak se nuk e kemi pranuar raportin e TM4 nga të hyrat indirekte. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për vitin 2023 është në shumë prej 1,987,398.32 € apo 100%. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për vitin 2023 është në shumë prej 472,647.31 € apo 98.97 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime komunale për vitin 2023 është në shumë prej 88,949.66 € apo 92.18 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për vitin 2023 është në shumë prej 86,955.42 € apo 96.31 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale për vitin 2023 është në shumë prej 818,083.65 € apo 84.88 %. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - dhjetor 2023 është në shumë prej 3,454,034.36 € apo 95 %. Në material i keni të specifikuar në mënyrë të detajuar.

Sherif Berisha thekson:- buxheti i komunës për vitin 2023 ka qenë në shumë prej 3,349,715.00 €, ndërsa ai përfundimtarë është në shumë prej 3,806,455.26 €. Kërkoj sqarim për këtë ngritje. Te financimi i investimeve kapitale janë disa kode të ndryshme por shumat janë të njëjta.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës buxheti fillestarë ka qenë 3,349,715.00 €, ndërsa përfundimtari është 3,806,455.26 € dhe kjo ngritje është ndikuar nga bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të cilat nuk janë shpenzuar viteve të kaluar dhe janë bartur në vitin 2023 dhe ngritja tjetër ka qenë prej donacionit Japonezë. Çdo drejtori e ka kodin e vetë dhe nënprogramet buxhetore dhe shumat janë të njëjta të shpenzimeve buxhetore.

Hyriete Isufi thekson:- më vjen mirë që është shpenzuar 95 % e buxhetit dhe mjetet e pa shpenzuara në cilën kategori kanë mbetur.

Lindita Ballazhi thekson:- prej granteve qeveritare është një pjesë që nuk është shpenzuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIARE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- mjetet që janë të dedikuara për ndarje të bursave janë në shumë prej 20, 000 € që do të përfitojnë katërdhjetë studentë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani i punës së Këshillave të Fshatrave për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- në plan parashihen të mbahen gjashtë mbledhje dhe aktivitet janë të shënuara . Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- një pjesë e fshatrave i kanë të kompletuara kryesit e këshillave të fshatrave , ndërsa në Han të Elezit nuk ka administratorë. Si do të veproni lidhur me këtë çështje.

Natyra Kalisi thekson:-nuk e di si e konstatooni që nuk ka administratorë për deri sa nuk ka dorëheqje zyrtare dhe për deri sa nuk kemi ndonjë dokument për dorëheqje, konsiderojmë që ka administratorë.

Kryesuesi thekson:- nuk është faji yt drejtoreshë sepse administratorët nuk mundesh me i mbajt me zor por vetëm duhesh me i kryer punët e tua si drejtoreshë. Nuk është mirë me potencuar që ka administratorë sepse nuk ka dhe e dinë mirë.

Natyra Kalisi thekson:- në bazë të rregullores për këshillat e fshatrave përcaktohen rregullat e dorëheqjes së administratorëve dhe në këtë rast me shkrim nuk kam që ka dhënë dorëheqje dhe në momentin që paraqet dorëheqjen do të vazhdojmë me procedurat e rizgjedhjes.

Sherif Berisha thekson:- administratorët kanë qenë me pagesë dhe tash ju ka ndërprerë pagesa dhe me shkrim nuk ju është dhënë asgjë. Nëse nuk ka pagesë nuk besoj që do të jenë aktiv.

Natyra Kalisi thekson:- me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga, komiteteve konsultative dhe këshillave të fshatrave ju është ndaluar pagesa. Kryetarëve të këshillave të fshatrave u dërgojmë mbushje telefonike por do të mundohemi që përmes kategorisë mallra dhe shërbime me gjet formë që me u a kryer pagesën.

Nora Xhoni thekson:- mungesa e administratorëve ka qenë çdo herë, para katër viteve, para tetë viteve dhe Lagja e Re vetëm në letër e ka pasur një administratorë dhe asnjë herë raport nuk ka dhënë përveç administratori i fshatit Gorancë që ka paraqit raport. Para se me shkuar jashtë vendit administratori është dashur me dhënë dorëheqje me shkrim.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Kërkesë për shfuqizimin e Planit të Integritetit me numër protokoli 01/6387/2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- me hyrjen në fuqi të vendimit të vendimit për miratimin e metodologjisë për planet e integritetit që është miratuar nga drejtori i agjensisë për parandalimin e korrupsionit, kemi pranuar një shkresë që obligohemi me i miratuar planet me metodologjinë e parë e cila e ka të qartë se si me vepruar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KËRKESA PËR SHFUQIZIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT ME NUMËR 01/6387/2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Kodit i Etikës dhe Mirësjelljes – Komuna Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- dokumenti është i hartuar me nevojat specifike të komunës duke i marrë rekomandimet e të gjitha drejtorive dhe akterëve të tjerë me rëndësi brenda institucionit të komunës. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Hyriete Isufi thekson:- a ka qenë më herët ky kodë apo është hera e parë.

Natyra Kalisi thekson:-ka qenë edhe më herët prej viti 2019 dhe kemi dashur me rifreskuar për shkak se nuk ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore të cilat kanë ndryshuar ndër vite.

Sherif Berisha thekson:- a do të jetë edhe për asamblenë.

Natyra Kalisi thekson:- po do të jetë edhe për asamblastët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KODI I ETIKËS DHE MIRËSELLJES –KOMUNA HANI I ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Diskutim rreth raportit të auditorit social.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe është një auditim social që është bërë nga një grup i qytetarëve në mënyrë që të angazhohen në ngritje të transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike. Ky raport i ka pasqyruar vërejtjet dhe sugjerimet për projektin e parkut “Isa Berisha”.

Sherif Berisha thekson:- në këtë raport janë shumë të gjetura të mëdha se asgjë nuk kishte shkuar në bazë të projektit.

Nexhmedin Daci thekson:- e para punës këto nuk janë auditorë të zyrës kombëtare të auditimit por kjo ka më shumë të bëjë më shumë me vërejtje apo propozime, mirëpo nëse shikohet vetëm projekti i ka kaluar të gjitha fazat madje edhe më shumë se sa është deshtë. Është i vetmi projekt që është mbajtur diskutim publik dhe pjesëmarrja ka qenë e lirë. Sa i përket rekomandimeve dhe dobësive që janë paraqitur e para është për vonesën e kryerjes së punimeve, punët shtesë të cilat nuk janë paraparë në projekt, vërejtja është te sistemi i ujitjes. Sa i përket vonesave ne nuk mundemi me paraparë kohën dhe me siguri e mbani mend se ka pasur reshje dhe nuk ka mundur me punuar dhe ato vonesa prej menaxherit të projekteve janë arsytuar. Te sistemi i ujitjes është shënuar që nuk ka ujë por nuk qëndron sepse unë ka por nuk ka mirëmbajtje për shkak se në projekt nuk është paraparë mirëmbajtja. Punët shtesë janë të parapara me ligj pra lejohen , ndërsa çështjet tjera që përmenden janë propozime të cilat nuk i kemi parë të arsyeshme i bërë sepse edhe buxhetin e kemi pasur të limituar.

Sherif Berisha thekson:-jeni zotuar për rekomandimet që i kanë dhënë . Parku po shkatërrohet dhe nuk janë ndërmarr masa.

Nexhmedin Daci thekson:- rekomandimet që janë dhënë kemi me i shikuar dhe në atë pjesë ka me u investuar edhe në të ardhmen.

Hyriete Isufi thekson:- a janë të vendosura kamerat në park dhe nëse ka a i këqyr dëmtimet dikush sepse pa shkuar në përgjegjësi dikush nuk ndalen. Ky park është vërtetuar se është i nevojshëm sepse qytetarët e kanë frekuentuar vazhdimisht.

Nexhmedin Daci thekson:- kamerat janë por edhe gjatë kryerjes së punimeve kompania i ka denoncuar në polici.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU DISKUTIMI RRETH RAPORTIT TË AUDITORIT SOCIAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8.Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI VEPRIMTARITË E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- për çështjen e administratorit besoj që do të ndërmerret iniciativë për me zgjedhë për shkak se nuk mundemi me lënë qytetin pa administratorë. Sa i përket parkut e kemi diskutuar edhe në mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës por nuk ka pasur diçka që ka shkuar keq por nëse ka gabime besoj që drejtoria përgjigjet për gabimet e veta. Është mirë që është rritur numri i studentëve për me marr bursë por nëse janë mundësit prej bizneseve është mirë me ju ndihmuar studentëve.

Sherif Berisha thekson:- drejtoresha e kulturës a do ta zbaton rregulloren për administrimin e shtëpisë së kulturës. Çështja e qenve endacak po bisedohet shumë herë por nuk po mundemi me arritur me zgjidhë këtë problem. Kërkoj nga ekzekutivi i komunës që ta harton një projekt për çështjen e kulmeve të cilat janë nëpër shtëpi që komuna tu a heqë shpenzimet. Taksitë që pajisen me leje është mirë që veturat të jenë më shumë se dhjetë vite të vjetra. Të rregullohet stacioni i autobusëve te ajo pjesa ku janë të vendosur kamionët , te drejtoria e Financave a keni ende fatura të hapura të cilat janë.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket faturave të papaguara do ti keni të bashkangjitura në materialin e mbledhjes së kuvendit të komunës.

Sevdi Dernjani thekson:-prej një apo dy projekteve të cilat i përmende neve na shkon buxheti komplet, ndërsa sa i përket realizimit të këtyre projekteve janë planifikimet buxhetore në afate të caktuara kohore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 13:01.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi,



Kryesuesi i Kuvendit
Florini Shkreta

